



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 14, datë 31.01.2023

PËR

**MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN JANAR 2023**

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”; Ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike“ i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2023”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 94 (nëntëdhjetë e katër) familje me një fond prej 302.981 (treqind e dymijë e nëntëqind e tetëdhjetë e njëmijë) lekë.
2. Miratimin e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike për këtë muaj gjithsej 1 (një) familje nga fondi i Bashkisë si më poshtë:

a. **Njësia Administrative Nr. 1**

Halil Cakri Mungesë dokumentacioni .

3. Miratimin e futjes në skemën e ndihmës ekonomike për muajin Janar 2023 të 3 (tre) familjeve, të cilat janë në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës si më poshtë:

a. **Njësia Administrative Nr. 3**

Fatmira Krasniqi Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 5400 lekë

Thanas Muka Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë


Alkida Islami Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3990 lekë

4. Miratimin e rihyrjes në skemën e ndihmës ekonomike me fond nga Bashkia të 0 (zero) familje.
5. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 02.02.2023



BASHKIA DURRE
09/02/23 273/5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRE

Nr. 85/prot.
2

Durrës, më 09.02.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRE**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRE**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 14 datë 31.01.2023 “Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë Durrës për muajin Janar 2023”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

